



Fermerët e bimëve medicinale - Në Malësinë e Madhe zgjerohen sipërfaqet e mbjella, prodhimi shkon për eksport

Faqe 5



- Portret -
Një vit pa Hasan Halilin
Nga: Hazis Sava, Kryetar në detyrë i BKFSH, (Bashkimi Kombëtar i Fermerëve Shqiptarë)

Faqe 7



Akademia e Shkencave të Shqipërisë Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë

Faqe 5



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit korrik 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 442
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

KASH - ZËRI NË MBROJTJE TË INTERESAVE TË FERMERËVE

RRAPAJ: DUHET KOOPERIM I FERMERËVE! TË KRIJOHET BURSA PËR PRODUKTET BUJQËSORE! REDUKTIMI I KOSTOVE, BUXHET SHITESË PËR SUBVENCIONIN E NAFTAËS

Kreu i Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj nuk i shikon grumbulluesit e produkteve bujqësore si një problem madhor në raport me prodhuesit, por thotë se zgjidhja që produktet të mos mbeten pa shitur është kooperimi i fermerëve. Një tjetër pikë shumë e rëndësishme, që sipas Rrapajt do i jepte fund problemeve të fermerëve është reduktimi i kostove, si dhe fillimi i punës për krijimin e një burse për disa nga këto produkte

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Nxisim përfshirjen e të rinjve në bujqësi dhe zbatimin e praktikave të mira bujqësore

Intervistë me Klajdi Çeka, Inspektor – Auditues, Albinspekt

Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri

Partner for Growth!

Ajencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2



Krifca: Negociata komplekse për 3 kapitujt e Bujqësisë në rrugën e afrimit me BE-në

Faqe 2

KËSHILLIM KARRIERE

A ka të ardhme për të rinjtë në Shqipëri?

Faqe 10

SIPËRMARRËS TË RINJ

Historia frymëzuese e Erindës

Ndonjëherë aftësia më e madhe profesionale është të 'rikrijojmë' veten!

Erinda Loçi

Faqe 10

BUJQËSI

Fermerët e lulediellit kërkojnë ndërtimin e një fabrike vaji: Ukrainën e kemi këtu

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët që kultivojnë bimët aromatike mjekësore (BAM) Fq.11
- Ushqimet e kombinuara dhe leverdia praktike e përdorimit të tyre në të ushqyerit e blegtorisë Fq.11
- Trajtimi i lopëve në periudhën e tharjes Fq.12
- E ardhmja e bujqësisë së ndërlidhur - Nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

RISI ALBANIA

BUJQËSI

Nxisim përfshirjen e të rinjve në bujqësi dhe zbatimin e praktikave të mira bujqësore

Intervistë me Klajdi Çeka, Inspektor – Auditues, Albinspekt

Klajdi është një teknolog ushqimor 28 vjeç, i cili punon që prej korrikut të vitit 2017 me Albinspekt Ltd si auditues. Albinspekt është një kompani certifikuese dhe inspektuese që operon në Shqipëri dhe Kosovë si pjesë e kompanisë bio inspecta me seli në Zvicër. Klajdi u përfshi në ngritjen e kapaciteteve audituese dhe certifikuese të kompanisë për kompanitë që aplikojnë standardin për certifikimin në grup GlobalG.A.P. dhe në lançimin e Agroquality, një platformë online – one-stop-shop që ofron informacion rreth kërkesave të certifikimit, platformë që u mbështet nga RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Klajdi është i angazhuar duke kontribuar në nxitjen e interesit të të rinjve për sektorin e agrobiznesit si dhe në arritjen e potencialit maksimal të sektorit përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare.

Këta fermerë nuk janë të lidhur drejtpërdrejtë me tregjet ndërkombëtare, çka e vështirëson komunikimin me blerësit e huaj dhe plotësimin e kërkesave të tyre. Nga ana tjetër eksportuesit që i njohin më mirë këto tregje nuk kanë informacionin e duhur sa i takon zbatimit të standardit GlobalG.A.P. e sidomos certifikimin në grup dhe se sa efektivë mund të jetë ai.



Shumë kompani eksportuese nuk kanë personelin me njohuritë dhe eksperiencën e duhur dhe nuk kanë akses tek konsulentët me ekspertizën e duhur që mund tu vijjnë në ndihmë për të siguruar certifikimin në grup GlobalG.A.P.

Mendoni se ka të rinj të cilët janë të interesuar për t'u bërë pjesë e këtij stafi dhe të zbatojnë standardin GlobalG.A.P.?

Në inspektimet apo auditimet që ne kemi bërë, pozitive është përfshirja dhe pjesëmarrja e të rinjve. Ne kemi eksperiencën e vitit të kaluar me një kompani të certifikuar, e cila punon me 60 fermerë, ku përveç të rinjve në linjën e prodhimit, ka edhe të rinj të përfshirë në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Këta janë të rinj të diplomuar që shfaqin interes për zbatimin e standardit GlobalG.A.P. Ne jemi në kontakt me kompani të ndryshme, ku kemi parë përfshirjen e të rinjve. Në inspektimet tona shohim të rinj të kualifikuar, por edhe nga ata që janë kthyer nga emigracioni e që ndërtojnë modele për njësitë e prodhimit. Përfshirja e të rinjve në këtë sektor mbetet një sfidë. Agrobiznesi nuk është shumë tërheqës për të rinjtë, pasi shihet si një sektor ku mbizotëron puna e rëndë e krahut, por ka shumë mundësi si ato që lidhen me sigurinë ushqimore dhe certifikimin. Kjo është karrira që kam zgjedhur unë. Mendoj se sektori privat duhet të jetë më shumë i lidhur me Universitetin Bujqësor të Tiranës pasi aty ka mjaft

elementë mjaft të mirë.

Cili është avantazhi i certifikimit në grup "GlobalG.A.P."?

"GlobalGAP" është një standard që ka të bëjë me zbatimin e praktikave të mira bujqësore për një produkt të sigurt. Përveç sfidës së prodhimit të produkteve ushqimore, kërko-

het edhe siguria dhe cilësia e prodhimit dhe ky është edhe slogani i GLOBALG.A.P. Thelbi është cilësia dhe siguria ushqimore, kjo është dhe sfida më të cilën duhet të përballlemi ne. Lajm i mirë është fakti që që kanë nisur përpjekjet për ta adresuar këtë çështje. Ka probleme, por ne kemi parë interes nga fermerët apo pikat e grumbullimit për arritjen e këtij standardi.

Ka interes nga kompani të tjera për të marrë certifikimin GlobalG.A.P.?

Unë ndihem optimist, por edhe duke e parë situatën me realizëm, që prej fillësive të certifikimit "Global Gap" të cilat kanë qenë certifikime individuale, fermerët që prodhonin në sasi të reduktuar nuk arrinin dot tregjet ndërkombëtare. Tani me mbështetjen e RisiAlbania shohim një dinamikë të re në përhapjen e GlobalG.A.P. në Shqipëri. Eksportuesit që mbështesin grupe fermerësh janë lidhur me tregjet e huaja dhe ofrojnë informacion mbi përfitimet e certifikimit në grup krahasuar me certifikimin individual. Ata janë të interesuar në çështjet e sigurisë ushqimore për të aksesuar tregjet e huaja evropiane dhe kanë kuptuar se çelësi i suksesit është bashkëpunimi dhe mbështetja ndaj fermerëve për zbatimin e standardit. Certifikimi në grup "GlobalG.A.P." është në fillësat e veta por është një trend në rritje në vendin tonë. Eksportuesit, fermerët e mëdhenj dhe konsulentët kanë mundësi të sigurojnë informacion falas, në gjuhën shqipe për standardin GlobalG.A.P.

Krifca: Negociata komplekse për 3 kapitujt e Bujqësisë në rrugën e afrimit me BE-në

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca e cilësoi Konferencën e Parë Ndërqeveritare Shqipëri-BE, një dritë jeshile në përbushjen e aspiratës së Kombit tonë drejt integritimit evropian.

Në një reagim, Krifca tha se "tre kapitujt e Bujqësisë: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, Siguria Ushqimore, Veterinaria dhe Politika Fitosanitare dhe Peshkimi, do të përbëjnë negociata komplekse dhe të forta gjatë rrugës sonë të afrimit të mëtejshëm të standardeve të sigurisë ushqimore, zhvillimit rural dhe skemave të politikës bujqësore me Bashkimin Evropian".

"Ne do ta shfrytëzojmë këtë mundësi për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor, për të garantuar akses në ushqim me standarde të larta sigurie dhe cilësi ushqimore, për të mbrojtur natyrën dhe mjedisin duke rritur të ardhurat e fermerëve, bletarëve, peshkatarëve dhe banorëve të zonave rurale", nënvizoi Krifca.

Sipas saj, bujqësia ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë, në aspektin ekonomik,

tutje do të ndërmarrë hapa edhe më të shpejtë e të nevojshëm për të afuar më tej sektorin



social dhe në ruajtjen e natyrës dhe vlerave të shoqërisë sonë.

"Shqipëria e ka nisur rrugën e saj të integritimit në bujqësi më përafshirje dhe një sërë aktesh të legjislativitetit, strukturën organizative institucionale, zbatimin e programit IPARD, por këtej e

tonë bujqësor me Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave dhe Integrimi do të na bëjnë më rezistent dhe do të hapin një sërë mundësish të reja e të mëdha për bujqësinë, për ekonominë, për Shqipërinë", tha Krifca.

Skemës kombëtare i shtohen 1,2 mld lekë; Krifca: Do rimbursohen 30 mijë lekë/ha fermerët e grurit, nga 1 korriku subvencionim të naftës edhe për peshkatarët

Qeveria në mbledhjen e sotme ka miratuar vendimin për rritjen e buxhetit me 1,2 miliardë lekë të skemës kombëtare në mbështetje të bujqësisë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca njoftoi se me rritjen e fondit do të shtohet edhe një masë e re në mbështetje të fermerëve që kultivojnë grurë. Masa e re parashikon mbështetje me subvencione direkte në vlerën e 30 mijë lekëve për ha të atyre fermerëve që kultivojnë grurin në hapësira mbi 1 ha.

"Kemi miratuar sot një fond shtesë prej 1,2 miliardë lekë që i shtohet buxhetit të skemës kombëtare të këtij viti duke e çuar buxhetin nga 3,7 miliardë lekë në 4,9 miliardë lekë. Është buxheti më i madh i vënë ndonjëherë në dispozicion. E shtymë edhe më tej këtë

gamë, sepse duam t'u vijmë në mbështetje të gjitha kërkesave të fermerëve për uljen e kostos së prodhimit. Ka qenë një vit i vështirë në përballimin e kostove, gjithsesi fermerët tanë kanë rezistuar.

Kemi pasur sezon mjaft të mbarë të grurit, gati historik. Hambarët janë mbushur plot. Janë prodhuar rreth 225 mijë ton grurë. Duke parë se çfarë po ndodh në botë me ndërprerjen e furnizimit të zinxhirit për të rritur pavarësinë tonë ushqimore për prodhimin e grurit kemi menduar të fusim një masë të posaçme ku për fermerët që prodhojnë mbi 1 ha do të kenë mundësinë të marrin mbështetje rreth 30 mijë lekë për ha. Gruri mbështet edhe me naftën pa taksë", tha ajo.

Ministria njoftoi miratimin

e vendimit për rritjen e fondit të naftës pa taksë me 500 milionë lekë. "Për kompensimin e naftës kemi çuar një buxheti të ri prej 500 milionë lekë për të rritur numrin e përfituesve. Aktualisht me skemën e rimbursimit të naftës numri i fermerëve përfitues është 30 mijë dhe brenda këtij viti kjo shifër do të shtohet deri në 50 mijë fermerë".

Sektori i peshkimit gjithashtu është prekur në kosto nga çmimi i naftës dhe i është ulur numri i ditëve të peshkimit sipas ministres së Bujqësisë. "Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave kemi vendosur që për këtë sektor të shtojmë buxhetin me 200 milionë lekë duke i subvencionuar për naftën 40 lekë për litër. kjo masë nis efektet nga 1 korriku 2022".



KASH - ZËRI NË MBROJTJE TË INTERESAVE TË FERMERËVE

RRAPAJ: DUHET KOOPERIM I FERMERËVE! TË KRIJOHET BURSA PËR PRODUKTET BUJQËSORE! REDUKTIMI I KOSTOVE, BUXHET SHITESË PËR SUBVENCIONIN E NAFTËS

Kreu i Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj nuk i shikon grumbulluesit e produkteve bujqësore si një problem madhor në raport me prodhuesit, por thotë se zgjidhja që produktet të mos mbeten pa shitur është kooperimi i fermerëve. Një tjetër pikë shumë e rëndësishme, që sipas Rrapajt do i jepte fund problemeve të fermerëve është reduktimi i kostove, si dhe fillimi i punës për krijimin e një burse për disa nga këto produkte

Kreu i KASH, Agim Rrapaj thotë se zgjidhja që produktet e fermerëve veçanërisht atyre të pa formalizuar të mos mbeten pa u shitur është kooperimi i tyre. Në emisionin e Report Tv "Sot Live në Shqipëri" me gazetarin Andi Kapxhiu, Rrapaj ka shpjeguar se si duhet të funksionojë procesi kooperimit, pra riorganizimi i veprimtarisë së fermerëve në mënyrë që produkti të mos u shkojë dëm. Moderatorin Kapxhiu solli në vëmendje se prej disa ditësh deputeti socialist, Erion Braçe ka akuzuar grumbulluesit, të cilët i ka cilësuar edhe si "grabitës". Por Rrapaj nuk i shikon grumbulluesit e produkteve bujqësore si një problem madhor, pasi sipas tij është e pamundur që Ata të bëjnë një marrëveshje për fiksimin e çmimeve edhe për arsye se janë të paorganizuar dhe të shumtë në numër. Kreu KASH theksoi se:

"Kooperimi i fermerëve në kushtet ekonomisë së tregut nuk ka asnjë lidhje me kolektivizimin që u aplikua në sistemin e kaluar, që aktualisht do të thotë fermerët duhet të grupohen e të riorganizohen, që të shesin në një mënyrë më dobiprurëse dhe të bëjnë prezent produktin e tyre, veçanërisht atë të pakontraktuar në të gjithë qendrat e grumbullimit. Etiketimi i këtyre qendrave si "grabitëse" nuk është zgjidhje e problemit. Përkundrazi aktualisht duhet mbështetur mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe procesi koordinimit midis qendrave të grumbullimit dhe fermerëve prodhues. Ato duhen mbështetur për t'u konsoliduar sepse akoma janë në hapat e para të veprimtarisë së tyre. Duhet të vijojnë të investojnë në përpunimin e sasisë së prodhimit që nuk mund të shitet i freskët, të rrisin kapacitetet e tyre depozituese frigoriferike, që t'ua blejnë prodhimet

fermerëve edhe kur nuk ka treg veçanërisht në periudhën pik të vjeljes, që atyre të mos i shkojë dëm prodhimi. Për këtë duhen marrëveshjet paraprake, kooperimi, mirëkuptimi, marrëveshje, kontrata dhe bursa", u shpreh Rrapaj në "Report Tv".

Rrapaj u ndal edhe tek disa nga arsyet përse është nxitur dhe krijuar kjo situatë e pafavorshme midis prodhuesve dhe grumbulluesve.

tot e larta, problemet me mekanikën bujqësore dhe frika për atë që i pret në të ardhmen etj., i bën Ata që të reduktojnë sipërfaqet e mbjella. tha Ai:

Prandaj të gjendur në këto kushte së bashku me shoqatat e fermerëve do na duhet të rivlerësojmë situatën dhe të gjejmë rrugë të tjera për të lehtësuar procesin e shitjes së prodhimeve të tyre.

"Duhet intensifikuar puna

fuqisë punëtore dhe mekanizimit në procesin e vjeljes? Pse u ndërpre procesi i nisur për krijimin e Bursës prodhimeve bujqësore? Institucioni bursës studion, parashikon, informon fermerët se çfarë duhet të mbjellin dhe kur duhet të vjelin, pasi është një nga instrumentet që rregullon momentin e shitjes dhe blerjes.

Mirëpo, që bursa të vihet në zbatim, Ai thotë se duhet të ketë disa ndryshime në ligjet

përfitim të dukshëm që fermeri ta kuptojë se fiton më shumë, kur ai është i kooperuar. Element i rëndësishëm është edhe drejtimi i këtyre shoqërive, në kemi akoma stafe teknike të kualifikuara, por nuk kemi drejtues administrativ të kualifikuar për SHBB. Duhet të ndryshojmë me ritme më të shpejta raportet e informalitetit, jemi në raporte 80 me 20, raport i zhdrejtë. Z. Rrapaj solli në vëmendje një sh-

është instrumenti që rregullon, momentin e shitjes dhe blerjes. Bursa mund të bëhet për secilin nga produktet që dalin në treg, bursa rregullisht nuk del nën kosto, nëse ndodh shteti ndërhyr me instrumentet e veta, godet rëndë informalitetin, është garanci për konsumatorin dhe fermerin. Duhet të nisim punë për Bursën edhe përmes mbështetjes së një projekti pilot, dhe do i kërkoja Agjencisë së menaxhimit të projekteve që ta mbështeste këtë kërkesë të hershme të KASH. Bursa aktualisht ka më shumë avantazhe afatgjata se sa afatshkurtera, por ky fakt nuk duhet të bëhet pengesë për të filluar punën në këtë drejtim pa humbur më shumë kohë", u shpreh Rrapaj.

Në fund, nisur edhe nga pasojat që kanë ardhur nga lufta në Ukrainë, Rrapaj tha se qeveria duhet të shtojë buxhetin për të gjithë sektorët e Ekonomisë, Ushqimit, veçanërisht për subvencionimin e naftës.

"Duhet të shtohet buxheti për vitin 2022, si dhe për subvencionin e naftës në veçanti. Në të gjithë sektorët e Ekonomisë Ushqimit, duhen rreth 50 mln litra karburant për gjithë vitin bujqësor. Subjektet prodhuese 50 mln litra i blinin para krizës me 65 mln euro. sot duhet të shpenzojnë për të realizuar të njëjtën sasi prodhimi rreth 107 mln euro. Pra mbi 40 mln euro më shumë. Qeveria aktualisht rimbursion 12 mln euro, prandaj duhet që të shtohet sasia e fondeve për karburantin. Skema aktuale po funksionon, por në kohë ka ndihmuar realisht 26 mijë nga 50 mijë fermerë që kanë aplikuar për të përfunduar sasinë e naftës pa taksë, nëse do e merrnin të gjithë në kohë e duhur do ishte një lehtësim për fermeret prodhues", përfundoi Rrapaj në emisionin e Report TV "Sot Live në Shqipëri".

embull konkret:

Japonia ka 8.6 mln fermerë, të gjithë janë të organizuar me shoqëri bashkëpunimi. Janë shoqëritë e bashkëpunimit që dalin dhe promovojnë produktet. Ato informojnë blerësit në kohën e duhur se kemi këto produkte në këtë periudhë dhe me këtë çmim, dhe tregjet reagojnë më mirë në këtë mënyrë. Çmimi vendoset mbas ankandit në konsultim me anëtarësinë dhe në këtë mënyrë askush nuk shet nën këtë çmim. Kështu ndërgjegjësohen prodhuesit dhe blerësit për një dysheme në çmim. Gjithashtu Bursa përveçse studion, parashikon, por edhe ndihmon fermerët se çfarë dhe kur duhet të mbjellin dhe vjelin,

torët e prodhimit e konkretisht duke filluar nga sektori:

Bujqësisë, Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Bimëve mjekësore Aromatike, Agropylltarisë dhe Bletarisë, Përpunimit të mbetjeve organike dhe përmirësimit e mjedisit në zonat rurale, Agrobiznesit dhe Tregjeve Agro blegtorale.

(Vijon në faqen 4)



"Nuk ka fakte që 227 qendra grumbullimi kanë një marrëveshje mes tyre për fiksimin e çmimeve. Në këtë mori qendrash grumbullimi është e paktë mundësia që të bëhet një marrëveshje e kësaj natyre. E dyta ka të bëjë me mungesën e marrëveshjeve dhe kontratave paraprake prodhues grumbullues. Vetëm rreth 42 mijë fermerë kanë marrëveshje e kontrata paraprake nga rreth 300 mijë fermerë që mendohet se kanë tepërcë produktesh. Fermerët që kanë marrëveshje dhe kontratë paraprake nuk kanë probleme dhe shqetësime madhore për shitjen e prodhimit. Për fermerët shkak kryesor për moslidhje kontrate mbetet pasiguria për prodhimin, kos-

e organeve shtetërore për të reduktuar informalitetin. Shkon sot një grumbullues informal me një mjet transporti dhe ia merr prodhimin fermerit me sa dëshirë ka grumbulluesi. Informimi dhe asistencë për prodhuesit duhet të vijojnë në të gjitha hallkat e procesit, jemi përqendruar dhe marrim statistika sa kemi mbjellë, por nuk fokusohemi tek statistikën dhe puna që duhet bërë dhe të pyesim: Sa marrëveshje e kontrata janë lidhur nga fermerët për shitjen e prodhimit? A kanë kapacitete qendrat e grumbullimit për blerjen e prodhimit? Sa studime janë bërë për konjunkturën e pritshme të tregut dhe sa e si shkojnë konkluzionet e tyre tek prodhuesit? Si e kemi situatën e

ekzistuese, si edhe në skemat e subvencionit.

"Duhet rifilluar puna për një bursë në fushën e prodhimeve bujqësore, që fermerët të shohin realitetin dhe t'i përshtaten ligjeve të ekonomisë së tregut. Bursa kërkon një formë tjetër organizimi me bashkime të ndryshme të prodhuesve, por me ligjin aktual fermerët nuk mund të bashkohen, sepse ligji 38/2012 "Për SHBB" e cilëson SHBB si fitimprurëse, që të funksionojë duhet të jetë jo fitimprurëse. E dyta, ka të bëjë me paketën fiskal, sistemi fiskal është i papërshtatshëm për këto shoqëri bashkëpunimi dhe në vijim duhet demonstruar në praktikë se SHBB përmes subvencioneve duhet të ketë një

25 % e numrit të NVM-ve janë nga sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit

për të realizuar procesin e prodhimit cilësor të ushqimeve dhe garantuar konsumatorin janë dhe duhen analizuar të lidhura ngushtësisht me ato të sektorëve të prodhimit. Rithek-

sojmë se situata e sektorit të agropërpunimit, analiza e shkaqeve, izolimi i dëmeve dhe eliminimi pasojave me ndikim negativ në cilësinë e ushqimit, duhet filluar pikërisht tek sek-

torët e prodhimit e konkretisht duke filluar nga sektori:

Bujqësisë, Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Bimëve mjekësore Aromatike, Agropylltarisë dhe Bletarisë, Përpunimit të mbetjeve organike dhe përmirësimit e mjedisit në zonat rurale, Agrobiznesit dhe Tregjeve Agro blegtorale.

(Vijon në faqen 4)



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR



SHOQATAT ANETARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në

7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Je startup apo inkubator? Tani mund të aplikoni për grante

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

SI TË APLIKONI TE THIRRJA E GRANTEVE PËR STARTUP

Vetëdeklarimi si startup ose lehtësues
Vetëdeklarohuni si startup ose lehtësues në portalin e-albania www.e-albania.al

Pajisja me pasaportë
Pas vetëdeklarimit në e-albania si startup ose lehtësues, ju do të pajiseni me pasaportën e startup-it/ lehtësuesit.

Aplikimi dhe afati
Aplikoni në website-in www.sipermarrja.gov.al, afati për aplikim do të jetë 16 Maj deri më 5 Qershor 2022.

Shpallja e fituesve
Shpallja e fituesve do të bëhet brenda 2 javëve nga mbyllja e aplikimeve me VKM.

A ka të ardhme për të rinjtë në Shqipëri?

Këtë numër të gazetës "Agrobiznesi", sjellim në vëmendje rubrikën "Këshillim karriere", nisma që mbështet të rinjtë të integrohen në tregun e punës. Gjithashtu 15 Korriku është Dita Botërore e Aftësive të Rinisë sipas Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i kësaj dite është të inkurajojë të rinjtë të përqafojnë vlerën e përvetësimit të aftësive si një mënyrë për të arritur suksesin dhe përmbushjen personale. Ndërkohë, në një treg pune gjithnjë në ndryshim, aftësitë e kërkuara pasqyrojnë dinamikën e tregut. Në RisiAlbania ne jemi të lumtur të bashkëpunojmë me disa ofrues trajnimesh që ju mundësojnë të rinjve në Shqipëri, aftësi të reja të kërkuara nga tregu si aftësitë e buta, aftësitë dixhitale, STEM, aftësitë e gjelbra dhe aftësitë e menaxhimit të karrierës.

Flasin të rinjtë:

Sipas Eglentit, bazuar në eksperiencat dhe njohjet e tij, Shqipëria është vendi ku potenciali gëlon, por fatkeqësisht nuk përdoret ose harxhohet në aktivitete të cilat nuk i shtojnë vlerë zhvillimit të brendshëm. Eglenti këshillon të rinjtë të mësojnë nëpërmjet eksperiencave të reja në treg dhe të guxuarit, pasi shkolla, thekson ai, është thjesht një pikë e vogël në oqeanin e mundësive.

Në vijim Kristi Mukollari na tregoi për një nismë të cilën ai, bashkë me shumë studentë të tjerë, ideuan dhe me të cilën janë angazhuar për pak kohë tashmë. E quajtur keshillim ne karriere, ajo është një hapsirë e lirë ku të rinjtë mund të kërkojnë mundësi zhvillimi dhe karriere si: punësim, trajnime, praktika, kurse etj. Donika ndau me ne gjithë bumën e madh që pati kjo plat-

formë në vetëm një muaj që prej krijimit të saj.

Këshillimi në karrierë është e mbështetur mbi një punë tërësisht vullnetare dhe jo fitimprurëse nga ana monetare, por e inspiruar nga mesazhet dhe mirënjohja e të rinjve të cilët po gjejnë mundësitë që kërkojnë me ndihmën e saj. Megjithatë Eglenti, përpos përgjimeve, u sugjeroi dy të rinjve të mendojnë për objektiva afatgjatë në lidhje me platformën.

Kristi sqaroi se Këshillimi jo vetëm po ofron mundësi punësimi dhe praktika por po zhvillohen edhe konferenca rinore dhe seminare me qëllim parësor ndihmën ndaj të rinjve shqiptar, ku çdokush mund të marrë pjesë.

Për këdo që është i interesuar të ndjekë Këshillimin ne Karrierë për të marrë më shumë informacion për platformën duhet ti drejtohet zyrës së Këshillimit në Bashkinë e Tiranës.

Historia frymëzuese e Erindës

Ndonjëherë aftësia më e madhe profesionale është të 'rikrijomë' veten!

Erinda Loçi

Një peng 30-vjeçar nga një xhirim televiziv i pa transmetuar në fëmijëri, kur priste me emocion të shikonte veten në ekran ndërsa ai xhirim ishte prerë, solli Erindën me ngul-

që nuk pushon së shprehuri një gjallëri mbresëlënëse. Ajo rrëfen për fëmijët e saj se dhe pse janë në moshë të vogël, nuk e bëjnë atë të dorëzohet së ndjekuri prioritetet që i ven-

mënyrë të përkushtuar. Kam në varësinë time, por mua më pëlqen më shumë të them se, punoj me 7 persona: 3 recepsionistë, 1 kuzhinierë, 2 sanitare dhe 1 financiere. Kjo është detyra ime e parë në sektorin e hotelierisë. Çelësi im i suksesit është që kam dëshirë të punoj në skuadër me të njëjtin qëllim, duke ofruar shërbim cilësor ndaj klientit. Erinda është gati të flasë me orë të tëra...

Sikur Erinda të mos kishte marrë guximin të kërkonte të provonte në tregun e punës, sot nuk do të ishte në një biznes që ajo pëlqen, duke drejtuar një ekip prej 7 personash dhe duke u rritur vazhdimisht profesionalisht, krahas përkujdesjes për familjen e saj të bukur.

Ka shumë të rinj që janë shkëputur nga tregu i punës ose nuk kanë arritur ende të integrohen në tregun e punës prej një kohe të gjatë për arsye nga më të ndryshmet. Sipas statistikave të 2019, 28.9% e të rinjve (15-29 vjeç) nuk janë të angazhuar as në punësim, as në edukim dhe as në trajnim. Kjo i bën më vulnerabël në qasjen ndaj tregut të punës. Por historia e Erindës na tregon se me vendosmëri, duke qënë vigjilent ndaj kërkesave të tregut dhe duke shkëmbyer me këshillues karriere dhe rekrutues, ky rrugëtim mund të jetë me i lehtë.

Takimi me Erindën ishte plot energji. Kjo vajzë kishte marrë me vete në çdo fjalë dhe shikim emocionin e asaj përvoja televizive që kurrë nuk do ta harronte. Flokët kaçurrela i levizin me ritmin e fytyrës që nuk pushon së shprehuri një gjallëri mbresëlënëse. Ajo rrëfen për fëmijët e saj se dhe pse janë në moshë të vogël, nuk e bëjnë atë të dorëzohet së ndjekuri prioritetet që i vendos vetes. Dhe prioriteti i radhës kush ishte? Perfeksionimi i profesionit si Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore.

mim "hakmarrës" me fatin e saj të dikurshëm në një program televiziv ku promovoheshin profesione specifike në Hoteleri-Turizëm. "Jam nënë e dy fëmijëve në moshat 6 dhe 7 vjeç. Për të rritur fëmijët braktisa punën si financiere dhe kam qëndruar 5 vjet e papunë. Po shikoja emisionin i cili më terhoqi kaq shumë, sa që thashë do thyej kompleksin e krijuar me ekranin në fëmijëri dhe do të provoj të hyj në garë për një profesion që nuk kisha provuar më parë. Më tërhoqi kaq shumë hoteliera sa e gjeta veten në një konkurs ku fitova vendin e dytë".

Erinda u bë konkurrenca pasi e kishte ndjekur emisionin një sezon më parë. E stimuluar nga fitorja e vendit të dytë, e përfshirë kokë e këmbë në profesionet e hotelierisë, nisi menjëherë pas mbylljes së programit një kurs për hoteliere tek Hospitality and Academy Tourism (HAT), ku fitoi çmimin e madh si performanca më e mirë nga Shkolla e Menaxhimit të Biznesit dhe Hotelierisë (BHMS), partner ndërkombëtar i Akademisë HAT.

Ku e gjen telefonata jonë muaj pas pjesëmarrjes në emisionin "Më i miri në vend" Erindën? Çmim pas çmimi, fitorja që i shenjoji jetën ishte vendi i punës si Menaxhere e Përgjithshme, përfshirë burimet njerëzore, në një nga hotelet më trend në kryeqytet "Botique Hotel".

Takimi me Erindën ishte plot energji. Kjo vajzë kishte marrë me vete në çdo fjalë dhe shikim emocionin e asaj përvoja televizive që kurrë nuk do ta harronte. Flokët kaçurrela i levizin me ritmin e fytyrës

dos vetes. Dhe prioriteti i radhës kush ishte? Perfeksionimi i profesionit si Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore.

E veshur me stil serioz, çantë të rëndë, paraqitet si një grua tashmë në karrierë. Veç kur nis e flet të kujton Erindën konkurrenca, e cila iu afrua emisionit për të provuar të punonte pas 5 vitesh jo aktive në tregun e punës. Erinda ka pasion të punojë me njerëzit ashtu siç profesioni i Burimeve Njerëzore e kërkon. Më pëlqen të punoj me njerëz, të njoh njerëz të rinj, të dëgjoj, të plotësoj dëshirat e klientëve, t'iu bëj surpriza, të organizoj stafin për dalje pas pune një herë në javë për të patur një frymë pozitive në punë, që së bashku të punojmë me dëshirë dhe motivim.

Qartazi Erinda, ish-konkurrenca e "Më i Miri në Ven", tashmë e ka vendosur veten në një tjetër dimension. Ajo nënë me fëmijë që shikonte dje emisionin televiziv nga divani i shtëpisë, e shkëputur nga tregu i punës, në pak muaj ka ndryshuar dhe fituar shumë. Ajo sot punon si Menaxhere e Përgjithshme e La Suite Boutique Hotel, i cili ndodhet në zemër të Tiranës. "Ajo që bëj këtu është të mbikëqyr çdo detaj në hotel."

Të bëj të mundur që çdo person të ndihet i motivuar dhe ta bëj punën në



Kristi Kumria



Eglent Bici



Donika Volaj



Kristi Mukollari



KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

KËSHILLA PËR FERMERËT
QË KULTIVOJNË BIMËT AROMATIKE
MJEKËSORE (BAM)

Gjatë muajit korrik, proceset kryesore që duhet të kryhen në sektorin e bimëve aromatiko mjekësore (BAM)

1. Vazhdim i vjeljes (korrijes) dhe përfundimi sa më parë i saj,
2. Tharja,
3. Standardizimin e magazinimit;
4. Ujitja për prodhime të dyta;
5. Shërbime në farishte për të siguruar fidan të shëndetshëm për vjeshtë

Vjelja. Çdo fermer që ka mbjellë BAM duhet të bëjë bilancin e punës për të përfunduar sa më parë vjeljen e prodhimit, pasi çdo shtyrje e afatit të mëtejshëm të këtij procesi është në dëm të prodhimit dhe të cilësisë.

Pathuajse të gjitha bimët kërkojnë një kohë vjelje kur kanë lulëzuar mbi 80% e tyre. Kjo periudhë përkon dhe me % më të lartë të vajit esencial dhe peshën maksimale të tyre. Këtë fazë tani BAM e kanë kaluar; për këtë arsye në mënyrë urgjente duhet të korren sipërfaqet e mbetura.

Tharja. Pas vjeljes, materiali i korur të dërgohet menjëherë në mjediset e mbrojtura nga dielli (hangar) dhe të ajro-

sura mirë për të filluar procesin e tharjes në rastet kur nuk është dorëzuar e njomë tek grumbulluesit.

Tharja është një proces i rëndësishëm që do të ndikojë direkt në ruajtjen e peshës, ngjyrës, aromës dhe cilësive të tjera të herbës.

Tharja në diell ndikon në mënyrë të ndjeshme në cilësinë tregtare të bimës, prandaj gjithmonë këshillohet që tharja të kryhet në hije. Për këtë arsye duhet që të merren masa që të sigurohen sa më shumë vende tharje (hangare, magazina, etj) të përshtatshme natyrale dhe me ventilim. Për të gjitha bimët aromatike e mjekësore, rekomandohet që procesi i tharjes të kryhet në mjedise pa diell dhe të ajrosura mire, duke shfrytëzuar për këtë qëllim si tharjen natyrale në hije dhe tharjen artificiale

me nxehtësi përmes hidratimit.

Standardizimi, magazinimi

Pas tharjes pasi largohen materiale të huaja, prodhimi pakëtohet në në thasë, kuti, çanta etj. Fermeri bazuar në kontratat me grumbulluesit duhet që të dorëzojë materialin sipas standardeve. Nëse nuk dorëzohet menjëherë, atëherë duhet të merren masa për ruajtjen e prodhimit deri në dorëzim. Për këtë fermeri duhet që:

- Të disponojë një magazinë, (për ruajtjen e prodhimit) e cila duhet të jetë e ajrosur mirë, të mundësojë variacione të temperaturës, dyert dritaret të mbrojtura me rrjeta teli, e dizenfektuar dhe e lyster me gëlqere.

- Materiali i paketuar nuk vendoset direkt në

dyshe me por mbi paletë drrese, larg murit,
- Në këto kushte materiali mund të ruhet deri në dorëzimin e tij tek grumbulluesit

Ujitja. Menjëherë mbas korrijes duhet të ndërhyhet me ujitje. Kur është e mundur, pas vjeljes, këshillohet që të realizohet një ujitje, për të gjitha bimët aromatike e mjekësore. Ujitja në këtë fazë, bën të mundur që bimët e prera të aktivizohen sa më shpejt:

- Për të siguruar vazhdimësinë e bimëve që rrezikohen nga temperaturat e larta në vazhdim.

- Për të marrë prodhime të dyta në rastet kur janë planifikuar nga fermeri.

- Numri i ujitjeve është në varësi të ecurisë së kohës.

Shërbimet në fidanishte. Për prodhim fidani për mbjellje të vjeshtës duhet të konsistojnë në:

- Ujitjet bazuar në nevojat e bimës.
- Eliminimi i barërave të këqia.

*Për sqarime të mëtejshme kontaktoni:
Msc. Gjesh Kronaj QTTB-Shkodër
Tel: 0673798499
E-mail: gjeshkronaj@hotmail.com*

**Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com**

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

USHQIMET E KOMBINUARA DHE LEVERDIA
PRAKTIKE E PËRDORIMIT TË TYRE NË TË
USHQYERIT E BLEGTORISË

(Informacion teknik për fermerët)

e cila është detyra e fermerit që të kujdeset për sigurimin e një racioni të plotë e të ballancuar. Në përgatitjen e ushqimeve të kombinuara, duhet të mbahet parasysh plotësimi i nevojave nga njëra anë dhe nga ana tjetër çmimi i përbërësve të tyre, në mënyrë që nga njëra anë bagëtive t'i plotësohen nevojat, por nga ana tjetër racioni të kushtojë sa më lirë, bëhet i mundur shfrytëzimi me efektivitetin e kapaciteteve prodhuese.

Përbërësit e ushqimeve të kombinuara:

- Ushqime Energjitime
- Ushqime Proteinike
- Lëndë Minerale

- Lëndë Vitaminoze
- Lëndë Plotesuese

Ushqimet më të rëndësishme energjitime për të ushqyerit e blegtorisë janë drithërat, të cilët normalisht zënë 50-80 % të racionit, por pjesën tjetër e zënë ushqimet proteinike si soja, bërshitë e lulediellit e tjerë.

Ndërsa lëndët minerale dhe vitaminat rriten kur kafshët kanë rendimente të larta prodhimi qumështi, atëherë bëhet e domosdoshme që ato të shtohen si lëndë plotësuese, ku burimi i sigurimit të tyre është Industria Kimike.

Kujdes!

Në qoftë se merni përsipër t'i kombinoni vetë



**Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com**

Çfarë është në të vërtetë një ushqim i kombinuar?

Janë disa lloje ushqimesh të përziera së bashku, në raporte të caktuara. Idea është, që me anë të kësaj përzierje të bëhet i mundur siguri i të gjitha lëndëve ushqyese, përfshi këtu edhe ato minerale e vitaminoze, të domosdoshme për nevojat e mbajtjes së trupit dhe prodhimit normal të kafshës. Kafshët si në kullotë apo në rregjim stallor nuk mund t'i plotësojnë dot nevojat me të gjitha elementet ushqyese pa një kombinim të bimëve foragjere.

Në faza të ndryshme të zhvillimit të bimësisë dhe në stinë të ndryshme të vitit, ka gjithmonë deficiente në drejtim të plotësimit të nevojave për kafshët, gjë që mund të çojë deri në gjendje urie të tyre.

Në qoftë se fermerë keni marrë përsipër të mbarështoni gjedhë në përgjithësi bagëti, atëherë duhet të kujdeseni që të krijoni të gjitha mundësitë për t'i plotësuar nevojat e tyre për të gjithë elementet ushqimorë. Natyrisht, kjo është e gjitha në interesin tuaj, sepse vetëm në këtë mënyrë, bëhet e mundur që kafsha të manifestojë mundësitë prodhuese të saj, pra të jetë ekonomikisht e leverdishme për ju.

Me të ushqyer të ballancuar të kafshëve bujqësore (ushqime të kombinuara) nënkuptojmë të ushqyerit e tyre me disa lloje ushqimesh të përziera në raporte të caktuara, pasi nevojat e tyre, në asnjë mënyrë nuk mund të plotësohen, duke përdorur vetëm një lloj ushqimi, sado "i mirë" qoftë ai. Është e domosdoshme pra të hartohet një racion ushqimor, duke përdorur sa më shumë përbërës dhe është pikërisht ky fakt, që na çon në sistemin e të ushqyerit me ushqime të kombinuara që të përmbajë energji, proteina, minerale dhe vitamina, në sasi të dhe raportet e duhura,

ushqimet, mos harroni përfshirjen në racion të sasisë së duhur të kripës së gjellës.

Fermerë!

Vlerësoni më shumë dhe më mirë të ushqyerit e blegtorisë, këshillohuni me specialistin, për teknologjinë e kombinimit dhe teknikën e përdorimit të ushqimeve për blegtorinë. Mos përdorni vetëm një lloj koncentrate, pasi asnjë ushqim i veçantë sado "i mirë" qoftë, nuk mund të jetë i plotë, prandaj konsultohuni me specialistin, për një kombinim sa më të efektshëm të tyre. Zgjidhja më e mirë e këtij problemi është blerja e ushqimeve të kombinuara të prodhuara nga Fabrikat e Ushqimeve për Blegtorinë, pasi në to ka edhe lëndë të tjera shtesë, të cilat ju e keni të vështirë t'i siguronit dhe praktikisht të pamundur t'i fusni në përzierjet që mund të përgatisni vetë. Jo vetëm kaq, por megjithëse në dukje "të shtrenjta" ushqimet e fabrikës janë më të lira se sa ushqimet që ju mund të "prodhoni" vetë.

Mos harroni!

Kafshët apo shpendët që ju mbani, duhet t'i konsideroni si "Fabrika" që punojnë për ju, por nga ana tjetër ato kanë nevojë për shërbim teknik të kualifikuar, në mënyrë që të prodhojnë me maksimumin e kapacitetit të mundshëm të tyre

Fermerë!

Merni informacionin e nevojshëm nga specialistët, që të mund të aftësoheni, për t'i trajtuar bagëtitë tuaja sa më mirë. Vetëm kështu, ju do të plotësoni njohuritë tuaja, për të prodhuar çdo vit, më shumë e me cilësi, për të qenë të aftë të konkuronit në kushtet e Ekonomisë së Tregut.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

TRAJTIMI I LOPËVE NË PERIUdhËN E THARJES

Përgatiti: Albi Shehu, Flamur Shabani

Në periudhën e fundit të laktacionit, duke filluar nga muaji i tetë i barsmerisë për shkaqe që do të përmenden më poshtë fillon periudha e tharjes, e cila përfundon me pjelljen e kafshës, pra me fillimin e laktacionit të ardhshëm.

Lopët për të ruajtur prodhimtarinë e qumështit kanë harxhuar gjatë periudhës së laktacionit nga rezervat trupore yndyrë, proteinë, lëndë minerale, vitamina.

Gjatë kësaj periudhe është forcuar zemra dhe sistemi nervor dhe është dëmtuar indi gjendror i gjirit. Prandaj në muajin e tetë të barsmerisë, siç e përmendëm më lart, lopët thahen. Kjo periudhë pushimi është e nevojshme për arsyet e mëposhtme:

- Për të zëvendësuar rezervat trupore të humbura gjatë laktacionit të mëparshëm dhe për të grumbulluar të tjera për atë që do të fillojë pas pjelljes.

- Për rigjenerimin e qelizave sekreteuese të gjirit.

- Për krijimin e kushteve optimale për rritjen e zhvillimit të fetusit i cili gjatë 2 muajve të fundit të basmerisë e rrit shumë peshën e tij (nga 15 deri 45 kg).

Periudha e tharjes, në kushtet normale zgjat dy muaj.

Kohëzgjatja e saj varet nga një sërë faktorësh si gjendja shëndetësore, niveli ushqimor gjatë laktacionit, mosha, prodhimtaria e parashikuar për laktacionin e ardhshëm etj.

Në varësi të tyre mund të ndryshojë me +15 ditë nga vlera normale.

kësaj ndërpritet mjelja.

Racioni ushqimor është në varësi të prodhimit ditor, pakësohet gradualisht: fillimisht ushqimet laksative (të njoma e koncentrate) dhe më pas po të jetë nevoja kufizohet edhe sasia e barit të thatë.

Në të njëjtën kohë sipas rastit mund të reduktohet edhe sasia e ujit të pijshëm. Ndërkaq mjelja vazhdon rregullisht por zgjatet intervali midis mjeljeve (kalohet nga 3 në 2 mjelje, në 24 orë) dhe njëkohësisht kontrollohet sasia ditore e qumështit.

Si për lopët me prodhimtari të lartë ashtu edhe për ato me prodhim ditor nën 10 kg qumësht, pas 2-3 ditësh nga mjelja e fundit bëhet një mjelje e plotë.

Njëkohësisht, si masë profilaktike ndaj mastiteve futet në çdo papilë nëpërmjet kanalit të saj, një dozë antibiotikësh dhe bëhet masazhi në mënyrë që të bëhet shpërndarja uniforme në të gjithë gjirin.

E njëjta procedurë përsëritet edhe pas dy - tre ditësh. Pas këtyre operacioneve fillon periudha e tharjes.

Ndodh që në disa raste veçanërisht në lopët me prodhimtari të lartë, të vërehen fryrje të gjirit. Kjo nuk është shqetësuese:

- Së pari sepse qumështi i grumbulluar nëpër alveola ndalon sekretimin e mëtejshëm të tij. Ai do të kalojë gradualisht nga gjiri në gjak dhe gjiri do të marrë formën tipike

tueshëm ndihmon në ruajtjen e parametrave optimale të mikroklimës në të.

Rëndësi të veçantë ka higjiena e trupit të kafshëve: Pastrimi me furçe e me pece, larja me ujë të ngrohtë ose të ftohtë (në varësi të temperaturës së ambientit), qethja e pjesëve me qime të gjata etj. janë masa mbrojtëse për mbarëvajtjen e shëndetit. Ato janë gjithashtu edhe një masazh i efektshëm e ndikon pozitivisht në qarkullimin e gjakut.

Është e këshillueshme që për këtë periudhë lopa të ketë shtresë të bollshme dhe të pastër për të mos u dëmtuar në pjesët delikate të trupit prej peshës së madhe të tij.

Problem i rëndësishëm në mbarshkrimin e lopëve gjatë kësaj periudhe është edhe mocioni funksional.

Është konstatuar se nëse gjatë dy muajve të fundit të basmerisë, lopëve nuk u bëhet mocioni i nevojshëm (jo më pak se 2-3 orë paradite dhe po aq pasdite) rastet e lindjeve të vështira, të parakohshme, të pozicioneve jo normale të fetusit, të mbetjeve të placentës, të edemave të gjirit etj. janë shumë më të shpeshta se në lopët që janë të lira e lëvizin në padok e veçanërisht në kullotë.

- Shëtitja në ajër të pastër dhe kullotja, ku është e mundur për një kohë relativisht të gjatë të ditës, e në temperaturë të lartë edhe natën, përveç funksionit profilaktik ndaj anomalive të lartpërmendura ndihmon në qarkullimin e gjakut, frymëmarrjen, për rregullimin normal të pozicionit të fetusit dhe për pjellje më të lehtë e më të shpejtë.

- Gjithashtu nën efektin e dobishëm të rrezeve të diellit përmirësohet procesi i sigurimit të vitaminës D, e cila ndikon pozitivisht si në gjendjen shëndetësore të lopës e të fetusit, ashtu edhe në efektivitetin riprodhues për periudhën pasardhëse.

- Për të parandaluar ndonjë çrregullim metabolik, që mund të shpjerë deri në dëshitim, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë cilësisë dhe higjienës së ushqimeve. Ato duhet të jenë absolutisht të pastër.

- Nuk duhen përdorur ushqime të papërshtatshëm e të mykura ose të kalbura e të ngrira.

- Uji që pinë lopët duhet të ketë temperaturë 10-12°C. Është më mirë të përdoren pirëse automatike. Në mungesë të tyre, lopëve u jepet të paktën 3 herë në ditë ujë.

Gjatë kësaj periudhe mund të ndodhë që gjiri të bëhet edhe edematoz. Edema mund të përfshijë edhe indet rreth e përçark të tij (në disa raste mund të shtrihet deri në kërthizë ose në vulvë) por në gjiri është më e theksuar, veçanërisht në pjesën e poshtme të tij.

Karakteristika të tjera të edemave përveç sa më sipër janë edhe tendosja tej mase e indit lidhës të gjirit dhe indeve që lidhin gjirin me pjesën tjetër të trupit, irritimi i tyre, rritja e temperaturës së trupit, së gjirit etj. Nëse edema nuk është e theksuar nuk duhet të preokupojemi sepse pas pjelljes ajo zhduket gradualisht si pasojë e rithithjes së lëngut të grumbulluar.

Të ushqyerit

Në këtë periudhë lopa duhet të ushqehet me një racion ushqimor me përmbajtje të ulët në energji, por me sasi të mjaftueshme të lëndëve minerale e vitaminave.

Një racion ushqimor ul rezikun e majmërisë, parandalon pjelljet e vështira, çrregullimet metabolike si ethja e qumështit, ketoza dhe sindromin e lopës së majmur.

- Gjatë muajit të parë të periudhës së tharjes sasia e lëndës ushqyese për nevojat e mirëmbajtjes duhet të jetë e barabartë me prodhimin e 2-4 kg qumësht.

- Ndërsa gjatë muajit të dytë të periudhës së tharjes, lopëve duhet t'u jepet një racion ushqimor për plotësimin e kërkesave që duhet për të prodhuar 5-7 kg qumësht.

Këto kërkesa përlogariten duke patur parasysh kondicionin trupor të lopës. Ushqimet voluminoze dhe ato me përmbajtje të fibrës, janë esenciale për funksionimin normal të plëndësit. Këshillohen ushqime fibroze me përmbajtje të ulët në energji.

Eksperimentalisht është provuar se lopët me periudhe normale tharje (60 ditë) prodhojnë gjatë laktacionit të ardhshëm 20% më shume qumësht se sa ato me periudhë tharje më pak se 30 ditë.

Akoma më të rënda janë pasojat për lopët që nuk thahen fare përveç prodhimtarisë së kufizuar të laktacionit të ardhshëm, ato do të pjellin viça të pazhvilluar mirë me peshë të vogël sepse lëndët ushqimore që marin gjatë kësaj kohe shkojnë pjesërisht për prodhimin e qumështit e pjesërisht për zhvillimin e fetusit.

Që këtë del qartë rëndësia e periudhës së tharjes për jetën produktive të lopës.

Rol të rëndësishëm luan teknika e tharjes, pasi nga zbatimi i përpiktë i saj varet mbarëvajtja e periudhës së tharjes.

- Për lopët që në fund të laktacionit prodhojnë rreth 10 kg qumësht në ditë, tharja është e thjeshtë, ndërpritet mjelja dhe për shkak të presionit që ushtron qumështi i prodhuar ndaj alveolave të gjirit frenohet sinteza e mëtejshme e tij.

- Kur prodhimi ditor para tharjes është më shumë se 10 kg në ditë, procesi i tharjes është më i vështirë, ai kërkon marrjen e disa masave paraprake për uljen e prodhimit ditor deri në 10 kg dhe pas

për lopën e tharë.

- Së dyti sepse futja e antibiotikeve ka krijuar në gjiri një mjedis steril, kështu që nuk ekziston rreziku i ndonjë infeksioni.

Trajtimi, kujdesi dhe të ushqyerit e lopëve në tharje ndryshojnë nga ato për lopët në laktacion.

Kujdesi më i madh gjatë kësaj periudhe ka lidhje si me gjendjen shëndetësore të lopës ashtu edhe me zhvillimin normal të fetusit. Për këtë duhet që lopët të mbahen në stallë të veçantë ose në mungesë të saj së paku në një aneks të stallës së lopëve.

Dyshemeja e stallës duhet të jetë e rrafshët për të mos mbajtur ujëra dhe e tillë që të mos shkaktojë rrëshqitjen e lopëve.

Përveç pastrimit të rregullt, mbi dysheme hidhet edhe një shtresë pluhur gëlqere e cila ndihmon si për thithjen e lagështirës së tepërt të ajrit e të dyshemesë ashtu edhe për dezinfektimin e saj.

Stalla e ajrosur dhe me ndriçim të mjaft

**Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com**

Një racion i mirë që duhet të sigurohet gjatë muajit të parë dhe të dytë të periudhës së tharjes duhet të përmbajë 6.5 kg lëndë të thatë si rezultat i përdorimit të silazhit dhe kashtrave sipas dëshirës. Sasia e ushqimeve duhet të jetë e kufizuar kur përmban sasi të lartë të energjisë. Dhjetë ditë para pjelljes racioni ushqimor rritet gradualisht, duke shtuar sasinë e koncentratës deri në 2 kg në ditë. Pas pjelljes vazhdon rritja e ushqimeve të koncentruara, në përputhje me prodhimin e parashikuar të qumështit.

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga faqja 14)

E ardhmja e bujqësisë së ndërlidhur

kapanoneve dhe depove mund të shkaktojnë rirënditje të automatizuara, duke reduktuar kostot e inventarit për fermerët, shumë prej të cilëve tashmë përdorin sisteme të tilla nga kompani si Blue Level Technologies. Mjete të ngjashme mund të përmirësojnë gjithashtu jetëgjatësinë e inputeve dhe të reduktojnë humbjet pas vjeljes duke monitoruar dhe optimizuar automatikisht kushtet e ruajtjes. Monitorimi i kushteve dhe përdorimi i ndërtesave dhe pajisjeve gjithashtu ka potencial për të reduktuar konsumin e energjisë. Vizioni kompjuterik dhe sensorët e bashkangjitur në pajisje dhe të lidhur me sistemet parashikuese të mirëmbajtjes mund të ulin kostot e riparimit dhe të zgjasin jetën e makinerive dhe pajisjeve. Zgjidhje të tilla mund të arrijnë 40 miliardë deri në 60 miliardë dollarë kursime në kosto deri në vitin 2030.

Bujqësia me dron

Bujqësia ka përdorur drone për rreth dy dekada, me fermerët në mbarë botën që mbështeten në pionierë si helikopteri i telekomanduar i Yamaha RMAX për të ndihmuar me spërkatjen e të mbjellave. Tani gjenerata e ardhshme e dronëve ka filluar të ndikojë në sektor, me aftësinë për të vëzhguar të korrat dhe tufat në zona të gjera shpejt dhe me

stot e pajisjeve dhe fuqisë punëtoare. Duke ulur kostot dhe duke përmirësuar rendimentet, përdorimi i dronëve mund të gjenerojë midis 85 dhe 115 miliardë dollarë në vlerë.

Makineri bujqësore autonome

Bujqësia autonome lejon që pajisjet bujqësore të tilla si traktorët të funksionojnë pa një shofer njerëzor. Teknologji të tilla si Trimble BX992 dhe pajisje të ngjashme lejojnë përdorimin me telekomandë dhe monitorimin e pajisjeve të fermës.

pronarë të fermave individuale. Veçanërisht në Azi dhe Afrikë, pak ferma punësojnë punëtorë të jashtëm. Në ferma të tilla, miratimi i zgjidhjeve të ndërlidhjes duhet të lirojë kohë të konsiderueshme për fermerët, të cilën ata mund ta përdorin për të kultivuar tokë shtesë me pagesë ose për të ndjekur punë jashtë industrisë.

Në gjejmë se vlera e vendosjes së lidhjeve të avancuara në këto ferma për të arritur efikasitete të tilla të punës përfaqëson pothuajse 120 miliardë dollarë, duke e çuar vlerën totale të ndërlidhjes së përmirë-

në ekosistemin e të dhënave për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me fermerët, njohurive të tyre për agronominë dhe historinë së tyre të inovacionit. Për shembull, një nga shpërndarësit më të mëdhenj në botë të plehrave tani ofron agentë plehëruës dhe softuer që analizon të dhënat në terren për të ndihmuar fermerët të përcaktojnë se ku t'i aplikojnë plehrat e tyre dhe në çfarë sasive. Në mënyrë të ngjashme, një prodhues i pajisjeve të mëdha po zhvillon kontrolle precize që përdorin imazhet satelitore dhe lidhjet automjet me automjet

zgjidhje.

Megjithatë, shumë nga kjo nuk mund të ndodhë derisa shumë zona rurale të kenë akses në një rrjet me brez të gjerë me shpejtësi të lartë. Për këtë parashikohen tre mënyra kryesore se si mund të bëhet investimi i nevojshëm për ta bërë këtë realitet:

Vendosja e drejtuar nga telekomanda

Megjithëse ekonomia e rrjeteve rurale me gjerësi të lartë bande në përgjithësi ka qenë e dobët, kompanitë telefonike mund të përfitojnë nga një rritje e mprehtë e kërkesës rurale për gjerësinë e brezit të tyre, ndërsa fermerët përqafojnë aplikacione të avancuara dhe zgjidhje të integruara.

Vendosja e drejtuar nga ofruesi

Ofruesit e inputeve, me njohuritë dhe marrëdhëniet e tyre ekzistuese të industrisë, janë ndoshta më të pozicionuar për të marrë drejtimin në investimet e lidhura me ndërlidhjen. Ata mund të bashkëpunojnë me kompanitë telefonike ose bizneset LPWAN për të zhvilluar rrjete të ndërlidhjes rurale dhe më pas t'u ofrojnë fermerëve modele biznesi që integrojnë teknologjinë e lidhur dhe mbështetjen e produkteve dhe vendimeve.

Vendosja e drejtuar nga fermeri

Pronarët e fermave, vetëm ose së bashku me grupet LPWAN ose kompanitë telefonike, mund të nxisin gjithashtu investimet. Kjo do të kërkonte që fermerët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë për të mbledhur dhe analizuar të dhënat në nivel lokal, dhe jo përmes palëve të treta, gjë që nuk është një pengesë e vogël. Por fermerët do të ruanin më shumë kontroll mbi të dhënat.

Pavarësisht se cili grup drejton investimet e nevojshme për lidhjen në bujqësi, asnjë ent i vetëm nuk do të jetë në gjendje ta bëjë këtë i vetëm. Të gjitha këto përparime do të kërkojnë që aktorët kryesorë të industrisë të përqafojnë bashkëpunimin si një aspekt thelbësor të të bërit biznes. Në vazhdim, fituesit në ofrimin e ndërlidhjes me bujqësinë do të kenë nevojë për aftësi të thella në fusha të ndryshme, duke filluar nga njohuritë e operacioneve të fermave deri të analizitës së avancuar e të dhënave dhe aftësia për të ofruar zgjidhje që integrohen lehtësisht dhe pa probleme me platformat e tjera dhe industrinë ngjitur. Për shembull, të dhënat e mbledhura nga traktorë autonomë duhet të rrjedhin pa probleme në kompjuterin që kontrollon pajisjet e ujitjes, të cilat nga ana e tyre duhet të jenë në gjendje të përdorin të dhënat e stacionit të motit për të optimizuar planet e ujitjes.

Megjithatë, pionierët e lidhjes në industri, tashmë kanë



Kontrollet më të sakta GPS të shoqëruara me vizionin kompjuterik dhe sensorët mund të avancojnë vendosjen e maki-

suar nga rezultatet direkte dhe indirekte në më shumë se 620 miliardë dollarë deri në vitin 2030. Masa në të cilën do të

për të përmirësuar efikasitetin e pajisjeve në terren.

Sidoqoftë, ndërlidhja e avancuar u jep lojtarëve të rinj një mundësi për të hyrë në hapësirë. Për një gjë, ofruesit e telekomit dhe LPWAN kanë një rol thelbësor për të luajtur në instalimin e infrastrukturës së ndërlidhjes së nevojshme për të mundësuar aplikacionet dixhitale në ferma. Ata mund të bashkëpunojnë me autoritetet publike dhe lojtarë të tjerë të bujqësisë për të zhvilluar rrjete rurale publike ose private, duke kapur një pjesë të vlerës së re në proces.

Kompanitë Agritech janë një shembull tjetër i lojtarëve të rinj që vijnë në sferën e bujqësisë. Ata specializohen në ofrimin e fermerëve produkte inovative që përdorin teknologjinë dhe të dhënat për të përmirësuar vendimarrjen dhe në këtë mënyrë për të rritur rendimentet dhe fitimet. Ndërmarrje të tilla agroteknike mund të ofrojnë zgjidhje dhe modele çmimesh që reduktojnë rrezikun e perceptuar për fermerët – për shembull, modele të abonimit që heqin barrën fillestare të investimit dhe lejojnë fermerët të zgjedhin në çdo kohë – që ka të ngjarë të çojnë në adoptim më të shpejtë të produkteve të tyre. Një agroteknologji italiane po e bën këtë duke ofruar monitorimin e ujitjes dhe mbrojtjes së të korrave për kantinat e verës me një tarifë sezonale, për hektar, duke përfshirë instalimin e pajisjeve, mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe mbështetjen e vendimeve. Agritech gjithashtu mund të bashkëpunojë me agrobizneset për të zhvilluar

kapet kjo vlerë, megjithatë, mbështetet kryesisht në mbulimin e avancuar të ndërlidhjes, i cili pritet të jetë mjaft i ulët, rreth 25 për qind, në Afrikë dhe pjesë më të varfra të Azisë dhe Amerikës Latine. Arritja e masës kritike të adoptuesve të nevojshëm për të krijuar një rast biznesi për vendosjen e lidhjeve të avancuara do të jetë gjithashtu më e vështirë në ato rajone, ku bujqësia është më e fragmentuar sesa në Amerikën e Veriut dhe Evropë.

Një evolucion në ndërlidhje përtej revolucionit 5G

Ndërsa industria e bujqësisë dixhitalizohet, ka të ngjarë të hapen xhepa të rinj me vlerë. Deri më sot, ofruesit e inputeve që shesin fara, lëndë ushqyese, pesticide dhe pajisje kanë luajtur një rol kritik

nerive bujqësore inteligjente dhe autonome. Fermerët mund të operojnë një sërë pajisjesh në fushën e tyre njëkohësisht dhe pa ndërhyrjen njerëzore, duke liruar kohë dhe burime të tjera. Makinat autonome janë gjithashtu më efikase dhe më të sakta për të punuar në një fushë sesa ato të drejtuara nga njerëzit, të cilat mund të gjenerojnë kursime karburanti dhe rendimente më të larta. Rritja e autonomisë së makinerive përmes ndërlidhjes më të mirë mund të krijojë vlerë shtesë prej 50 deri në 60 miliardë dollarë deri në vitin 2030.

Teknologjitë e ndërlidhura ofrojnë një përfitim shtesë, indirekt, vlera e të cilit nuk përfshihet në vlerësimet e dhëna në këto raste përdorimi. Industria globale bujqësore është shumë e fragmentuar, me pjesën më të madhe të punës së bërë nga



efikasitet ose si një sistem rele për transferimin e të dhënave në kohë reale në pajisje dhe instalime të tjera të lidhura. Dronët mund të ndihmojnë fermerët për të optimizuar përdorimin e inputeve (fara, plehra, ujë), për të reaguar më shpejt ndaj kërcënimeve (barërat e këqija, dëmtuesit, kërpudhat), për të kursyer kohë në kërkimin e të korrave (vërtetojnë trajtimin/veprimet e ndërmarra), për të përmirësuar shkallën e ndryshueshme recetat në kohë reale dhe vlerësimi i rendimentit nga një fushë. Dronët gjithashtu mund të përdorin vizionin kompjuterik për të analizuar kushtet në terren dhe për të ofruar ndërhyrje të sakta si plehrat, lëndët ushqyese dhe pesticidet aty ku kulturat kanë më shumë nevojë për to. Ose ata mund të mbjellin farën në vende të largëta, duke ulur ko-

filluar t'i zhvillojnë këto aftësi të reja nga brenda. Organizatat preferojnë mbajtjen e brendshme të të dhënave pronësore mbi operacionet për arsye konfidencialiteti dhe konkurrence. Ky nivel kontrolli gjithashtu i bën të dhënat më të lehta për t'u analizuar dhe e ndihmon organizatën të jetë më e përgjegjshme ndaj nevojave në zhvillim të klientit.

Por zhvillimi i aftësive të reja nuk është loja përfundimtare. Lojtarët e bujqësisë në gjendje të zhvillojnë partneritete me operatorët e telekomit ose lojtarët LPWAN do të fitojnë ndikim të rëndësishëm në ekosistemin e ri të lidhur me bujqësinë. Ata jo vetëm që do të jenë në gjendje të blejnë pajisje të ndërlidhjes më lehtë dhe më të përballeshme përmes këtyre partneriteteve, ata gjithashtu do të pozicionohen më mirë për të zhvilluar marrëdhënie të ngushta me fermerët pasi ndërlidhja bëhet një çështje strategjike. Kështu, ofruesit ose shpërndarësit e inputeve mund ta gjenin veten në një garë ndërlidhjeje. Nëse ofruesit e inputeve arrijnë të zhvillojnë partneritete të tilla, ata mund të lidhen drejtpërdrejt me fermerët dhe të ndërpresin plotësisht shpërndarësit. Nëse distributorët fitojnë atë garë, ata do të konsolidojnë pozicionin e tyre në zinxhirin e vlerës duke mbetur një ndërmjetës thelbësor, më afër nevojave të fermerëve.

Sektori publik gjithashtu mund të luajë një rol duke përmirësuar ekonominë e zhvillimit të rrjeteve me brez të gjerë, veçanërisht në zonat rurale. Për shembull, qeveritë gjermane dhe koreane kanë luajtur një rol të madh në bërjen e zhvillimit të rrjetit më tërheqës duke subvencionuar shumë spektrin ose duke ofruar lehtësime tatimore për kompanitë telefonike. Rajone të tjera mund të përsërisin këtë model, duke përshepuar zhvillimin e produkteve ndërlidhëse duke u dhënë me kosto efektive ofruesve të inputeve dhe kompanive agroteknike sigurinë e një shtylle kurri-zore mbi të cilën ata mund të ofrojnë shërbime. Vendosja eventuale e konstelacioneve satelitore LEO ka të ngjarë të ketë një ndikim të ngjashëm.

Bujqësia, një nga industritë më të vjetra në botë, e gjen veten në një udhëkryq teknologjik. Për të trajtuar me sukses kërkesën në rritje dhe disa tendenca përçarëse, industria do të duhet të kapërcejë sfidat për vendosjen e lidhjeve të avancuara. Kjo do të kërkojë investime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe një riorganizim të roleve tradicionale. Është një ndërmarrje e madhe, por kritike, me më shumë se 500 miliardë dollarë vlerë në rrezik. Suksesi dhe qëndrueshmëria e një prej industrive më të vjetra të planetit mund të varet nga ky transformim i teknologjisë dhe ato që e përqafojnë atë në fillim mund të jenë më të pozicionuar për të lulëzuar në të ardhmen e drejtuar nga lidhjet e bujqësisë

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

